

**UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E
FORMULARËVE TË KËRKESAVE**

Ministria e Brendshme



PËRMBAJTJA

A. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE.	3
B. UDHËZIME TË POSAÇME PËR PLOTËSIM SIPAS UNITETEVE	6
B1. UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E UNITETEVE TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA KËRKESAT	6
B2. UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E UNITETEVE TË KËRKESAVE TË VEÇANTA	8
110. Pajisja me Leje Qëndrimi.....	8
120. Rinovimi i Lejes së Qëndrimit	8
130. Kërkesë për Aprovim Pune	8
140. Vërtetim Special Qëndrimi të Ligjshëm (Rinovim ose Pajisje)	8
150 Pajisje e re me Leje Qëndrimi.....	9
160. Viza e hyrjes	9
210. Ndryshimi i adresës së banimit	10
211 Ndryshim i gjendjes personale.....	10
212 Ndryshim punëdhënësi - Profili punësimi.....	11
213 Ndryshim i të dhënave të Indeditetit.....	11
220 Humbje dokumenti udhëtimi/ leje qëndrimi	12
230 Zëvendësimi ose pajisje e re me dokument udhëtimi	12
240 Denoncimi i kontratës së punës.....	13
310 Kërkesë e Përgjithshme.....	13
320 Kërkesë Informimi	13
340 Kërkesë Shpejtimi	13
350 Kërkesë Korrigjimi	14
360 Kërkesë Dorëheqjeje	14
410 Kërkesë Plotësuese	14
510 Dorëzimi i të Dhënave Shtesë	14



A. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE

110. Pajisje me Leje Qëndrimi

Aplikohet për pajisje me leje qëndrimi (hyrje në shtetin grek me vizë ose lindje në shtetin grek)

120. Rinovim Leje Qëndrimi

Aplikohet për rinovimin e lejes së mëparshme të qëndrimit, e cila ose është marrë ose është në proces.

130. Aprovim për të drejtë Pune (Rinovim ose Pajisje)

Aplikohet për nxjerrje vendimi aprovues për të drejtë në tregun e punës.

140. Vërtetim special Qëndrimi të Ligjshëm (Rinovim ose Pajisje)

Aplikohet për pajisje me vërtetim special qëndrimi të ligjshëm për të interesuarin për rastet kur është në proces shqyrtimi kërkesë anulimi ose vendim lirimi të tij nga burgu me kushte kufizuese.

150. Pajisje e re me Leje Qëndrimi

Aplikohet për pajisje të re me leje qëndrimi për rastet kur është nxjerrë leja me të dhëna të gabuara, për raste ndryshimi ose korrigjimi të emrave dhe mbiemrave ose edhe të pasaportës, si dhe për raste ndryshimi të kategorisë së lejes së qëndrimit.

160. Vizë hyrjeje

Aplikohet për nxjerrje vendimi aprovues për vizë hyrjeje të anëtarëve të familjes (bashkëshort/e ose fëmijë të mitur).

161. Formular plotësues për vizë hyrjeje

Aplikohet bashkë me kërkesën për vizë hyrjeje në rast se kërkuesi dorëzon kërkesë për më shumë se një fëmijë.

210. Ndryshim adrese banimi

Aplikohet në rast ndryshimi të të dhënave për adresën e banimit. Kërkuesi detyrohet të plotësojë të dhënat për adresën e mëparshme dhe atë aktuale.



211. Ndryshim i gjendjes personale

Aplikohet në rast ndryshimi të gjendjes personale dhe lidhet me rastet e ndryshimit të shtetësisë, shkurorëzimit, martesës ose lindjes së fëmijës.

212. Ndryshim punëdhënësi – profili punësimi

Aplikohet në rastet e ndryshimit të punëdhënësit ose të profilit të punësimit.

213. Ndryshimi i të dhënave të identitetit

Aplikohet në rast ndryshimi të të dhënave të identitetit. Kërkuesi detyrohet të shënojë të dhënat e mëparshme dhe ato aktuale të identitetit. Veç asaj kërkohet motivimi i ndryshimit të mësipërm.

220. Humbja e dokumentit të udhëtimit / lejes së qëndrimit

Aplikohet në rast humbeje të dokumentit të udhëtimit ose të lejes së qëndrimit dhe kërkohet plotësimi i të dhënave të identitetit.

230. Zëvendësim ose pajisje me dokumenti të ri udhëtimi

Aplikohet në rast zëvendësimi ose pajisje me dokumenti të ri udhëtimi dhe kërkohet plotësimi i të dhënave të dokumentit të mëparshëm të udhëtimit dhe të atij aktual.

240. Denoncim i kontratës së punës

Aplikohet në rast denoncimi të kontratës së punës dhe kërkohet plotësimi i të dhënave të punëdhënësit.

310. Kërkesë e përgjithshme

Aplikohet në rastin kur i interesuari dëshiron të dorëzojë kërkesë e cila nuk mbulohet nga kërkesat e veçanta që disponohen.

320. Kërkesë informimi.

Aplikohet në rastin kur i interesuari dëshiron të informohet në lidhje me ecurinë e kërkesës në proces. Kërkohet të shënohet numri i protokollit të kërkesës në proces.

330. Kërkesë rishqyrtimi

Aplikohet në rastin kur i interesuari dëshiron rishqyrtimin e kërkesës që iu refuzua. Kërkohet të shënohet numri i protokollit të saj.



340. Kërkesë shpejtimi

Aplikohet në rastin kur i interesuari dëshiron shpejtimin e procesit të pajisjes ose të rinovimit të lejes së qëndrimit. Kërkohet të shënohet arsyeja e shpejtitimit.

350. Kërkesë Korrigjimi

Aplikohet në rastin kur i interesuari kërkon korrigjimin e vendimit të disfavorshëm në lidhje me pajisjen ose me rinovimin e lejes së qëndrimit.

360. Kërkesë Dorëheqjeje

Aplikohet në rastin kur i interesuari dëshiron të heqë dorë nga kërkesat e dorëzuara për pajisje me leje qëndrimi ose për rinovim, në rastet e fitimit të shtetësisë greke, të largimit nga shteti, ose për arsye tjetër. Kërkohet të plotësohet arsyeja e dorëheqjes.

410. Kërkesë Plotësuese

Aplikohet në rastin kur kërkohet nga i interesuari dokumentacion shtesë. Kërkohet të shënohet numri i protokollit të kërkesës përkatëse dhe numri i protokollit të korrespondencës përkatëse.

510. Dorëzimi i të dhënave statistikore

Aplikohet nga i interesuari në rastet kur kërkon ose Pajisje me Leje Qëndrimi ose Rinovim Leje Qëndrimi ose Vërtetim Special Qëndrimi të Ligjshëm dhe dorëzohet bashkë me formularët përkatës (110, 120 dhe 140).

Të dhënat që plotësohen me këtë kërkesë do të përdoren vetëm për nxjerrjen e të dhënave statistikore.



B. UDHËZIME TË POSAÇME PËR PLOTËSIM SIPAS UNITETEVE

B1. UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E UNITETEVE TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA KËRKESAT

Në vendin me treguesin **Fotografia me ngjyra e të interesuarit, e kohëve të fundit [1]** vendoset nga Shërbimi fotografia që ka sjellë i interesuari.

Vendi me treguesin **Vendi i vulës së Protokollit të Prefekturës së Qarkut [2]** vulozet nga Shërbimi kompetent i Prefekturës së Qarkut.

Të dhënat **Prefektura e Qarkut [3], Bashkia / Komuna [4] dhe Numri i Protokollit - data [5]** plotësohen nga Shërbimi.

Në vendin që gjendet mbi treguesin **Nënshkrimi i të interesuarit [420]** nënshkruan i interesuari.

UNITETI: Të Dhënat e Identifikimit të të interesuarit

Plotësohen të dhënat **Mbiemri [20], Emri [21], Datëlindja [23], Shtetësia [28], dhe Mashkull/Femër [22]** siç janë shënuar në dokumentin e udhëtimit të të interesuarit. Në rastin kur të dhënat **Shteti i lindjes [29], Mbiemri i babait [24], Emri i Babait [25], Mbiemri i Nënës [26] dhe Emri i Nënës [27]** janë shënuar në dokumentin e udhëtimit ose në dokumentacionin e bashkëngjitur, plotësohen siç janë. Në rast të kundërt plotësohen sipas deklaramit.

UNITETI: Leje Qëndrimi

Uniteti **Leje Qëndrimi** lidhet vetëm me rastet që është nxjerrë leja e mëparshme e qëndrimit dhe plotësohen të dhënat **Numri i Lejes (GR) [43] dhe EKA [44]** siç janë shënuar në lejen e mëparshme të qëndrimit. Veç asaj zgjidhet tipi i formularit përkatës nga treguesit **Leje Qëndrimi [40], Kartë Qëndrimi [41] dhe Kartë Qëndrimi të Përhershëm [42]**

E dhëna **Autoriteti lëshues [9]** plotësohet nga Shërbimi.

UNITETI: Dokumenti i Udhëtimit

Plotësohen të dhënat **Numri [50], Data e skadimit [51] dhe Shteti lëshues [53]** siç janë shënuar në dokumentin e udhëtimit. Në rastin kur **Data e skadimit** është **Pa kufizim [52]** plotësohet kutia përkatëse. Në rast se i interesuari nuk ka



pasaportë ose dokument tjetër udhëtimi, zgjidhet treguesi **Pa pasaportë ose dokument tjerër udhëtimi [54]**.

E dhëna **Tipi [15]** plotësohet nga Shërbimi.

UNITETI: "Plotësohet nga kërkuesi kur ai nuk është i interesuari"

Në rastin kur kërkuesi nuk është personi i interesuar por i autorizuari i të interesuarit, detyrohet ky të plotësojë Unitetin me treguesin **"Plotësohet nga kërkuesi kur ai nuk është personi i interesuar"** me të dhënat **Mbiemri [60], Emri [61], Emri i babait [62]** dhe **Shtetësia [63]** siç janë shënuar këto në Letërnjoftimin ose në Pasaportën e tij. Në treguesin **Letërnjoftim/pasaportë [64]**, plotësohet numri përkatës. Të dhënat **Bashkia/Komuna [65], Rruga [66], Numri [67], dhe Kodi Postar [68]**, plotësohen në bazë të adresës së banimit të kërkuesit. Në vendin që gjendet mbi treguesin **Nënshkrimi i aplikuesit të kërkesës [421]** nënshkruan aplikuesi i kërkesës.



B2. UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E UNITETEVE TË KËRKESAVE TË VEÇANTA

110. Pajisja me Leje Qëndrimi

Të dhënat **Nr rendor i Vërtetimit të nxjerrë [6], Ligji [7] dhe Kodi i Kategorisë [8]** plotësohen nga Shërbimi.

UNITETI: Të dhëna mbi Vendbanimin dhe Komunikimin

Plotësohen të dhënat **Bashkia/Komuna [80], Rruga [81], Numri [82], Kodi Postar [83] dhe Telefonat [84]: i Shtëpisë [85]** sipas adresës së punës së të interesuarit. (Shënim: kërkohet saktësi në plotësimin e të dhënave të mësipërme sepse nëpërmjet tyre do të komunikojë shërbimi me të interesuarin).

Në treguesin **Telefonat [84], Celulari [86], dhe i Punës [87]**, plotësohet respektivisht numri i telefonit celular të të interesuarit dhe numri i telefonit të vendit të punës së të interesuarit.

120. Rinovimi i Lejes së Qëndrimit

Të dhënat **Nr rendor i Vërtetimit të lëshuar [6], Ligji [7] dhe Kodi i Kategorisë [8]**, plotësohen nga Shërbimi.

130. Kërkesë për Aprovim Pune

Të dhënat **Pajisje [10], Rinovim [11], Ligji [7] dhe Kodi i Kategorisë [8]**, plotësohen nga shërbimi.

140. Vërtetim Special Qëndrimi të Ligjshëm (Rinovim ose Pajisje)

Të dhënat **Pajisje [10], Rinovim [11], Nr. Rendor i Vërtetimit të mëparshëm [14], Ligji [7] dhe Kodi i Kategorisë [8]**, plotësohen nga shërbimi.



UNITETI: Motivimi

Ndërmjet treguesve **Vendim Gjyqësor pezullimi [100]** dhe **Lirim nga burgju me kushte kufizuese [101]** i interesuari zgjedh atë që motivon kërkesën e tij për pajisje ose për rinovimin e vërtetimit special për qëndrim të ligjshëm.

150 Pajisje e re me Leje Qëndrimi

UNITETI: Leje për Pajisje të re

Plotësohen të dhënat **Numri i Lejes (GR) [113]** dhe **EKA [114]** siç janë shënuar në lejen për pajisje të re të të interesuarit. Veç asaj zgjidhet tipi i formularit përkatës nga treguesit **Leje Qëndrimi [110]**, **Kartë Qëndrimi [111]** dhe **Kartë Qëndrimi të Përhershëm [112]**.

E dhëna **Autoriteti lëshues [9]** plotësohet nga Shërbimi.

160. Viza e hyrjes

UNITETI: Shkaku i pajisjes së re

Plotësohen të dhënat **Mbiemri [130]**, **Emri [131]**, **Datëlindja [134]**, **Shtetësia [135]**, **Mashkull/Femër [133]**, **Numri i pasaportës [136]** dhe **Data e skadimit [137]** siç janë shënuar në pasaportën e bashkëshortit/es së të interesuarit. Në rastin kur **Data e skadimit** është **Pa kufizim [138]**, plotësohet treguesi përkatës. Në rasin kur e dhëna **Emri i Babait [132]** është shënuar në pasaportën e bashkëshortit/es ose në dokumentacionin e bashkëngjitur, plotësohet siç është. Në çdo rast tjetër plotësohet sipas deklarimit.



UNITETI: Të Dhënat e Fëmijës

Plotësohen të dhënat **Mbiemri [150]**, **Emri [151]**, **Datëlindja [154]**, **Shtetësia [155]**, **Mashkull/Femër [153]**, **Numri i pasaportës [156]** dhe **Data e skadimit [157]** siç janë shënuar në pasaportën e fëmijës së të interesuarit. Në rastin kur **Data e skadimit** është **Pa kufizim [158]**, plotësohet treguesi përkatës. Në rasin kur e dhëna **Emri i Babait [152]** është shënuar në pasaportën e fëmijës ose në dokumentacionin e bashkëngjitur, plotësohet siç është. Në çdo rast tjetër plotësohet sipas deklarimit.

210. Ndryshimi i adresës së banimit

UNITETI: Të dhëna mbi Adresën e Mëparshme

Plotësohen të dhënat **Rrethi [170]**, **Bashkia/Komuna [171]**, **Rruga [172]**, **Numri [173]** dhe **Kodi Postar [174]** sipas adresës së mëparshme të banimit të të interesuarit.

UNITETI: Të dhëna mbi Adresën Aktuale

Plotësohen të dhënat **Rrethi [180]**, **Bashkia/Komuna [181]**, **Rruga [182]**, **Numri [183]** dhe **Kodi Postar [184]** sipas adresës së re të banimit të të interesuarit. (Shënim: kërkohet saktësi në plotësimin e të dhënave të mësipërme sepse nëpërmjet tyre do të komunikojë shërbimi me të interesuarin). Në mënyrë plotësuese shënohet e dhëna **Telefoni [185]** si vijon: **I Shtëpisë [186]** sipas adresës së banimit të të interesuarit, e dhëna **I Punës**, sipas vendit të punës së të interesuarit dhe e dhëna **Celulari [187]** me numrin e celularit të të interesuarit.

211 Ndryshim i gjendjes personale

UNITETI: Të Dhëna mbi Ndryshimin

Ndër treguesit **X Zgjidhje martese [200]**, **X Anullim martese [201]**, **X Vdekje bashkëshorti/e [202]**, **X Lidhje martese [203]**, **X Lindje Fëmije [204]** dhe **X Ndryshim Shtetësie [205]**, i interesuari zgjedh atë që lidhet me ndryshimin e gjendjes së tij personale. Në çdo rast plotësohet treguesi **Data e Ndryshimit [207]** siç është shënuar në dokumentacionin përkatës të bashkëngjitur. Në rast se zgjidhet treguesi **Ndryshim Shtetësie [205]** plotësohet shtetësia e re e të



interesuariat në treguesin **Shtetësia e Mëparshme [206]**. Në rast se zgjidhet ndonjëri nga treguesit **Zgjidhje martese, Anullim martese, Vdekje bashkëshorti/e ose Lidhje martese**, plotësohen **Të dhënat e bashkëshortit [208]: Mbiemri [209], Emri [210] dhe Emri i Babait [211]** siç janë shënuar në pasaportën ose në letërnjoftimin e bashkëshortit/es. Në treguesin **Pasaportë /skadimi ose Letërnjoftimi [212]** plotësohet ose numri i pasaportës së bashkëshortit/es dhe data e skadimit, ose numri i letërnjoftimit në treguesin **Letërnjoftimi**. Në rast se zgjidhet treguesi **Lindje Fëmije** plotësohen **Të Dhënat e Fëmijës [213], Mbiemri [214] Emri [215], Emri i babait [216], Datëlindja [217] dhe Mashkull/Femër [218]** siç shënohen këto në certifikatën e lindjes së fëmijës.

212 Ndryshim punëdhënësi - Profili punësimi

UNITETI: Të Dhëna mbi ndryshimin

Plotësohen të dhënat **Punëdhënësi [230], Emërtimi [231], NIPT (AFM) [232], Adresa [233], Lloji i kontratës së punës [234], Data e nxjerrjes [235], Data e fillimit [236], dhe Data e Skadimit [237]**, siç janë shënuar këto në kontratën e punës së të interesuarit. Në rast se afati i kontratës së punës është **Pa kufizim [238]** zgjidhet treguesi përkatës.

213 Ndryshim i të dhënave të Indeditetit

UNITETI: Të Dhënat e Mëparshme të Idenditetit të të Interesuarit

Plotësohen të dhënat **Mbiemri [250], Emri [251], Emri i babait [252], Shtetësia [253], Datëlindja [254]**, siç qenë në fuqi para ndryshimit dhe janë shënuar në pasaportën e të interesuarit.

UNITETI: Të Dhënat Aktuale të Idenditetit të të Interesuarit

Plotësohen të dhënat **Mbiemri [260], Emri [261], Emri i babait [262], Shtetësia [263], Datëlindja [264]**, siç janë aktualisht në fuqi.



UNITETI: Motivimi i Ndryshimit

Ndërmjet treguesve **Ndryshim Gjendje Civile [270]** dhe **Ndryshim Datëlindjeje [277]**, i interesuari zgjedh atë që motivon ndryshimin e të dhënave të indenditetit të tij. Në rastin kur motivimi i ndryshimit nuk mbulohet nga treguesit e mësipërm, zgjidhet treguesi **Ndryshim Tjetër (sqarojeni) [278]**. Në rast se zgjidhet treguesi **Ndryshim i Gjendjes Civile**, në vazhdim do të zgjidhet njëri nga treguesit e poshtëshënuar (**Pagëzim [271]**, **Martesë [272]**, **Shkurorëzim ose Anullim martesë [273]**, **Njohje fëmije [274]**, **Birësim Fëmije [275]** dhe **Zgjidhje birësimi fëmije [276]**).

220 Humbje dokumenti udhëtimi/ leje qëndrimi

UNITETI: Dokument Udhëtimi i Humbur

Në rast humbjeje të dokumentit të udhëtimit plotësohen të dhënat **Numri [291]**, **Data e skadimit [292]** dhe **Shteti lëshues [294]** siç janë shënuar këto në dokumentin e humbur të udhëtimit. Në rast se **Data e Skadimit** është **Pa kufizim [293]** plotësohet treguesi përkatës.

E dhëna **Tipi [15]** plotësohet nga Shërbimi.

UNITETI: Leje Qëndrimi e Humbur

Në rast humbjeje të lejes së qëndrimit plotësohen të dhënat **Numri i Lejes [314]** dhe **A.K.A. [315]** siç janë shënuar këto në dokumentin e humbur të lejes së qëndrimit. Veç asaj, zgjidhet tipi i dokumentit përkatës nga treguesit **Leje Qëndrimi [311]**, **Kartë Qëndrimi [312]** dhe **Kartë Qëndrimi të Përhershëm [313]**.

E dhëna **Autoriteti Lëshues [9]** plotësohet nga Shërbimi.

230 Zëvendësimi ose pajisje e re me dokument udhëtimi

UNITETI: Të dhënat e dokumentit të udhëtimit që zëvendësohen

Plotësohen të dhënat **Numri [320]**, **Data e skadimit [321]** dhe **Shteti lëshues [323]** siç janë shënuar në dokumentin e mëparshëm të udhëtimit. Në rast se **Data e Skadimit** është **Pa Kufizim [322]** plotësohet treguesi përkatës.



E dhëna **Tipi [15]** plotësohet nga Shërbimi.

UNITETI: Të dhënat e Dokumentit të ri të Udhëtimit

Plotësohen të dhënat **Numri [330]**, **Data e skadimit [331]** dhe **Shteti lëshues [333]** siç janë shënuar në dokumentin aktual të udhëtimit. Në rast se **Data e Skadimit** është **Pa kufizim [332]** plotësohet treguesi përkatës.

E dhëna **Tipi [15]** plotësohet nga Shërbimi.

240 Denoncimi i kontratës së punës

UNITETI: Të dhënat e punëdhënësit

Plotësohen të dhënat **Punëdhënësi [340]**, **Emërtimi [341]**, **NIPT [342]**, **Adresa [343]** dhe **Data e denoncimit [344]** siç janë shënuar në denoncimin e kontratës së punës.

310 Kërkesë e Përgjithshme

Në treguesin **Kërkesë për [350]**, plotësohet teksti që analizon kërkesën e të interesuarit.

320 Kërkesë Informimi

Në treguesin **Nr. Prot i kërkesës [360]**, plotësohet numri i protokollit të kërkesës për ecurinë e së cilës kërkon të informohet i interesuari.

340 Kërkesë Shpejtimi

Në treguesin **Arsyeja e shpejtimit [381]**, përshkruhet arsyeja për të cilën i interesuari kërkon shpejtimin e kërkesës së tij dhe në treguesin **Nr. Prot. i kërkesës [380]**, numri i protokollit të kërkesës së të interesuarit që është akoma në proces.



350 Kërkesë Korrigjimi

Në treguesin **Nr. Prot i kërkesës së atakuar [390]**, plotësohet numri i protokollit të vendimit të disfavorshëm që kërkon interesuari të korrigojë.

Në kërkesë bashkëngjitet detyrimisht memorial ku shënohen arsyet për të cilat kërkohet ndryshimi ose anulimi i vendimit të atakuar.

360 Kërkesë Dorëheqjeje

UNITETI: Arsyja e Dorëheqjes

Ndër treguesit **Fitim i Shtetësisë Greke [400]** dhe **Largim nga Shteti [401]** zgjidhni atë që mbulon arsyen e dorëheqjes nga kërkesa. Në rast se arsyeja nuk mbulohet nga zgjedhjet e mësipërme, zgjidhni treguesin **Arsye tjetër (sqaroheni) [402]** dhe plotësojeni me përshkrimin e arsyes së dorëheqjes nga kërkesa.

410 Kërkesë Plotësuese

Në treguesin **Nr. Prot. i kërkesës përkatëse [410]**, plotësohet numri i protokollit të kërkesës për të cilën i interesuari aplikon dokumentacion shtesë dhe në treguesin **Nr. Prot. i korrespondencës përkatëse [411]** plotësohet numri i protokollit të korrespondencës përkatëse me të cilën shërbimi kompetent informoi për nevojën e aplikimit të dokumentacionit shtesë.

510 Dorëzimi i të Dhënave Shtesë

Të gjithë treguesit plotësohen sipas deklarimit të të interesuarit.

Plotësimi i treguesve që shënohen në formular me shkronja të theksuara është i detyrueshëm. (**Data e hyrjes për herë të parë në Greqi [508]**, **Shteti i qëndrimit të mëparshëm [518]** dhe **Nëse keni në plan të emigroni në shtet tjetër (në rast se po, sqaroni destinacionin [523])**).

Ndër treguesit **Pa Shtetësi [500]**, **Kërkesë për shtetësi greke [501]**, **refugjat me status të njohur [502]** dhe **Mbrojtje Ndihmëse [503]** i interesuari zgjedh vetëm ato që karakterizojnë gjendjen e tij personale aktuale.

Ndër treguesit me zgjedhje shumëfishe, (**Gjendja familjare [509-513]**, **Gjendja e punësimit [524-526]**, **Niveli Arsimor [536-544]** dhe **Njohja e Gjuhës Greke [545-553]** i interesuari zgjedh vetëm njërin nga ato që propozohen, atë që karakterizon gjendjen e tij personale aktuale.



Shënim: Për sa i përket unitetit të zgjedhjes shumëfishe, **Niveli Arsimor**, i interesuari zgjedh vetëm nivelin më të lartë të arsimit.

Përkthimi u bë nga dokumenti greqisht
Athinë, 28.07.2008
*Përkthyesi **Telemak Koça***